

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KRMP-26-6343-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizimi me Gjenerator per nevojat e zyres Regjionale- RI TENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SMART MODEL LLC

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KALABRI

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+ 383 (0) 49-19 21 48

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Zymer Veliu Veliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Smartmodel.rks@gmail.com

(Adresa elektronike)

16.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

31.07.2026 Njoftimi për Kontratë është publikuar në e-prokurim
19.08.2026 Afati i fundit për dorëzim në ora 10:00
31.07.2026 Kërkesa për informata sqaruese
13.08.2026 Kërkesa për rishqyrtim
14.08.2026 Pergjigjeja për OE në kërkesën për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				Jo	☒	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me

arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me Gjenerator per nevojat e zyres Regjionale- RI TENDER, Kodi i procedurës: KRMP-26-6343-1-2-1

Ankues:

SMART MODEL LLC, Prishtinë

Kundër:

K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.

Operatori Ekonomik SMART MODEL LLC paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 14.08.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret e dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi me Gjenerator per nevojat e zyres Regjionale- RI TENDER**”.

Vlerësojmë se kriteret e kontestuara janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Në bazë të rrethanave të mësipërme, Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur, ndër të tjera:

1. Nenin 7 të LPP-së

Parimi i barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit, për shkak të kufizimit të konkurrencës.

2. Nenin 28 të LPP-së

Specifikimet teknike, për shkak të vendosjes së kërkesave konstruktive që nuk janë

arsyetuar si domosdoshmëri funksionale.

3. Nenin 6 të LPP-së

Economiciteti dhe efikasiteti, në kuptim të nevojës për sigurimin e konkurrencës dhe përdorimin sa më efikas të fondeve publike.

4. Nenin 27 të LPP-së

Në lidhje me kërkesat dhe përgatitjen e specifikimeve të Dosjes së Tenderit.

5. Nenin 108/A dhe 109 të LPP-së

Në lidhje me të drejtën e operatorit ekonomik për mjetet juridike dhe shqyrtimin e pretendimeve të tij.

6. Dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022

Për përgatitjen e Dosjes së Tenderit, specifikimet teknike, rishqyrtimin dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Këto janë edhe dispozitat që Ankuesi ka identifikuar në formularin e Kërkesës për Rishqyrtim

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me përgjigjen e dhënë nga AK-ja në kërkesën për rishqyrtim të datës 14.08.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- **K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizimi me Gjenerator për nevojat e zyres Regjionale- RI TENDER”** ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Ankesë kundër qëndrimit/vendimit të Autoritetit Kontraktues për moslargimin dhe mosreformulimin e specifikimeve teknike diskriminuese të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, të cilat kufizojnë në mënyrë të pajustificuar konkurrencën dhe pamundësojnë pjesëmarrjen reale të operatorëve ekonomikë me produkte ekuivalente.

Një rrethanë veçanërisht e rëndësishme në rastin konkret është se **ky aktivitet prokurimi është zhvilluar edhe më parë me të njëjtat specifikime teknike dhe procedura e parë është anuluar për shkak se asnjë nga operatorët ekonomikë dhe modelet e ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë specifikimet teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit.**

Pikërisht për këtë arsye, Ankuesi, gjatë procedurës së radhës, ka kërkuar që Autoriteti Kontraktues **t'i largojë ose riformulojë specifikimet teknike diskriminuese**, në mënyrë që të krijohet mundësi reale për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe produkteve ekuivalente.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka larguar këto specifikime dhe ka vazhduar me të njëjtat kërkesa teknike.

Kjo e bën kufizimin e konkurrencës **jo vetëm potencial, por të provuar nga rezultati i procedurës së mëparshme.**

PRANUESHMËRIA E ANKESËS

SMART MODEL LLC është operator ekonomik i interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Ankuesi ka ushtruar paraprakisht të drejtën për Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke kërkuar konkretisht rishikimin dhe largimin/riformulimin e specifikimeve teknike diskriminuuese.

Në Kërkesën për Rishqyrtim, Ankuesi ka kundërshtuar në mënyrë të detajuar specifikimet e Aneksit 1 dhe ka kërkuar që ato të bazohen në kërkesa funksionale, performancë, kapacitet, standarde dhe parametra objektive.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka pranuar këto kërkesa dhe nuk ka eliminuar kriteret kontestuese. Për këtë arsye, Ankuesi i drejtohet OSHP-së për mbrojtjen e të drejtës për pjesëmarrje të barabartë dhe për sigurimin e një procedure reale dhe efektive konkurruese.

RRETHANAT FAKTIKE TË RASTIT

1. Procedura aktuale

Autoriteti Kontraktues ka publikuar aktivitetin e prokurimit:

“Furnizimi me Gjenerator për nevojat e Zyrës Regionale – RI TENDER”, me nr. KRMP-26-6343-1-2-1.

Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit janë përcaktuar, ndër të tjera, këto kërkesa:

- kapacitet motori: **6.49 litra;**
- motor me **6 cilindra;**
- **Bore × Stroke: 105 × 125 mm;**
- raport kompresimi **16:1;**
- fuqi motori **120 kW Standby / 110 kW Prime;**
- alternator me **PMG dhe Dual AVR.**

Këto kërkesa, të marra në tërësi, përbëjnë një kombinim shumë specifik konstruktiv dhe teknik.

RRETHANA KRYESORE: I NJËJTI TENDER ËSHTË ANULUAR MË PARË PËR SHKAK TË MOSPËRMBUSHJES SË SPECIFIKIMEVE

Kjo është një nga rrethanat më të rëndësishme që duhet të merret parasysh nga OSHP.

Ky aktivitet prokurimi është zhvilluar më parë me specifikime teknike të njëjta ose esencialisht të njëjta me ato të procedurës aktuale.

Në procedurën e parë, operatorët ekonomikë kanë paraqitur modele të ndryshme të gjeneratorëve, mirëpo **asnjëri prej modeleve të ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1.**

Si rezultat, procedura e parë është anuluar.

Kjo rrethanë ka rëndësi të veçantë juridike dhe faktike për këtë procedurë të re, sepse demonstroi se problemi i identifikuar nga Ankuesi nuk është thjesht një supozim apo një interpretim subjektiv.

Përkundrazi:

Procedura e mëparshme ka dhënë një rezultat konkret: asnjë nga modelet e ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë specifikimet teknike të Aneksit 1.

Prandaj, kur Autoriteti Kontraktues e përsërit procedurën duke ruajtur të njëjtat kërkesa

teknike, lind një pyetje thelbësore:

Nëse specifikimet e njëjta kanë rezultuar më parë në pamundësi të përmbushjes së tyre nga operatorët ekonomikë dhe kanë çuar në anulimin e procedurës, përse në procedurën e re nuk janë rishikuar dhe përshtatur këto specifikime për të mundësuar konkurrencë reale?

Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme pasi Ankuesi ka kërkuar pikërisht që, në këtë procedurë të dytë, të eliminohen parametrat konstruktivë të panevojshëm dhe të mundësohet pjesëmarrja e produkteve ekuivalente.

QËLLIMI I ANKUESIT NUK ËSHTË ULJA E KËRKESAVE TEKNIKE

SMART MODEL LLC nuk ka kërkuar që Autoriteti Kontraktues të ulë cilësinë apo performancën e gjeneratorit.

Përkundrazi, kërkesa e Ankuesit është që Autoriteti Kontraktues:

- të ruajë fuqinë e nevojshme;
- të ruajë performancën e kërkuar;
- të ruajë kapacitetin;
- të ruajë standardet e cilësisë;
- të ruajë sigurinë dhe besueshmërinë;
- por të **largojë parametrat konstruktivë që nuk janë të domosdoshëm për funksionimin e gjeneratorit.**

Ankuesi ka kërkuar që specifikimet të bazohen në:

- fuqinë;
- kapacitetin;
- performancën;
- efikasitetin;
- besueshmërinë;
- standardet;
- sigurinë;
- emetimet;
- funksionalitetin;
- dhe parametra të tjerë objektivisht të nevojshëm.

Pra, kërkesa është që **më shumë prodhues të mund të konkurrojnë për të njëjtin rezultat teknik**, jo që Autoriteti Kontraktues të blejë një produkt me cilësi më të ulët.

SPECIFIKIMET AKTUALE NUK JANË VETËM KUFIZUESE - ATO JANË PROVUAR TË JENË TË PAMUNDURA PËR T'U PËRMBUSHUR NË PROCEDURËN E PARË

Ky është dallimi themelor ndërmjet kësaj ankese dhe një ankese hipotetike ndaj specifikimeve.

Ankuesi nuk po pretendon vetëm:

“Këto specifikime mund të kufizojnë konkurrencën.”

Por ekziston një rrethanë konkrete:

Me këto specifikime është zhvilluar më parë procedura e tenderimit dhe asnjë nga modelet e ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë ato, duke rezultuar në anulimin e tenderit.

Prandaj, vazhdimi me të njëjtat specifikime krijon rrezik real që edhe procedura aktuale:

1. të mos prodhojë konkurrencë efektive;
2. të mos mundësojë pjesëmarrje të mjaftueshme;
3. të rezultojë përsëri me mungesë të ofertave të përshtatshme;
4. të çojë në një tjetër anulim të procedurës;
5. dhe të vonojë realizimin e nevojës së Autoritetit Kontraktues.

Në këto rrethana, rishikimi i specifikimeve nuk është vetëm në interes të operatorëve

ekonomikë, por edhe në interes të vetë Autoritetit Kontraktues dhe realizimit të suksesshëm të prokurimit.

SHKELJA E NENIT 7 TË LPP-së – PARIMI I BARAZISË DHE MOS-DISKRIMINIMIT

Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Nenin 7 të LPP-së**, i cili garanton trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë dhe ndalon zhvillimin e procedurës në mënyrë që redukton ose eliminon konkurrencën.

Në rastin konkret, efekti diskriminues rezulton nga kombinimi i parametrave teknikë.

Nuk është e domosdoshme që Dosja e Tenderit të përmendë drejtpërdrejt emrin e një marke.

Një specifikim mund të jetë diskriminues edhe kur nuk përmend markën, nëse **kombinimi i parametrave konstruktivë identifikon praktikisht një konfigurim të caktuar dhe përjashton produktet e tjera ekuivalente**.

Kjo është pikërisht çështja që Ankuesi ka ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim.

SHKELJA E NENIT 28 TË LPP-së – SPECIFIKIMET TEKNIKE

Neni 28 i LPP-së kërkon që specifikimet teknike të:

- jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit;
- sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë;
- mos favorizojnë ose diskriminojnë operatorët ekonomikë;
- dhe, kur është e përshtatshme, të bazohen në standarde, performancë dhe kërkesa funksionale.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një seri parametrash konstruktivë shumë specifikë.

Ankuesi nuk e konteston nevojën për një gjenerator me fuqi dhe performancë të caktuar.

Kontestohet **përcaktimi i mënyrës së ndërtimit të motorit**, kur një rezultat i njëjtë teknik mund të arrihet nga prodhues të ndryshëm përmes konfigurimeve të ndryshme.

Në Kërkesën për Rishqyrtim është theksuar se ekuivalenca duhet të vlerësohet në bazë të:

- kapacitetit;
- fuqisë;
- performancës;
- efikasitetit;
- besueshmërisë;
- standardeve;
- sigurisë;
- emetimeve;
- funksionalitetit;
- dhe parametrave operacionalë.

AUTORITETI KONTRAKTUES NUK KA DËSHMUAR SE PARAMETRAT JANË FUNKSIONALISHT TË DOMOSDOSHËM

Autoriteti Kontraktues pretendon se specifikimet janë hartuar mbi bazën e nevojave funksionale dhe se ato janë kërkesa minimale.

Megjithatë, nuk është dhënë një përgjigje konkrete për pyetjet:

Pse duhet të jetë motori pikërisht 6.49 litra?

Pse duhet të ketë Bore × Stroke pikërisht 105 × 125 mm?

Pse duhet të ketë raport kompresimi pikërisht 16:1?

Pse duhet të jetë fuqia e motorit pikërisht 120 kW Standby / 110 kW Prime?

Pse duhet të jetë kombinimi PMG + Dual AVR?

Në Kërkesën për Rishqyrtim janë ngritur pikërisht këto pyetje, ndërsa AK nuk ka identifikuar ndonjë model konkret nga prodhues tjetër që i përmbush të gjitha parametrat në mënyrë kumulative.

PRETENDIMI “LEJOHEN PRODUKTET EKUIVALENTE” NUK ËSHTË I MJAFTUESHËM

Autoriteti Kontraktues është mbështetur edhe në argumentin se operatorët ekonomikë mund të ofrojnë produkte ekuivalente.

Ky argument është vetëm formal nëse specifikimet e vendosura e bëjnë praktikisht të pamundur që produktet e tjera të konsiderohen ekuivalente.

Nëse, për të qenë “ekuivalent”, një produkt duhet të ketë:

- të njëjtin kapacitet motori;
- të njëjtin numër cilindrash;
- të njëjtin Bore × Stroke;
- të njëjtin raport kompresimi;
- të njëjtën fuqi;
- të njëjtin kombinim PMG/Dual AVR,

atëherë pyetja është:

Çfarë kuptimi real ka termi “produkt ekuivalent”?

Ekuivalenca duhet të lidhet me **rezultatit dhe performancën e produktit**, jo me kopjimin e parametrave konstruktivë të një konfigurimi të veçantë.

MUNGESA E HULUMTIMIT TË DOKUMENTUAR TË TREGUT

AK ka deklaruar se ka kryer hulumtim të tregut.

Megjithatë, nuk ka identifikuar:

- prodhuesit e analizuar;
- modelet konkrete;
- numrin e produkteve që i përmbushin parametrat;
- tabelën krahasuese;
- arsyetimin teknik;
- apo prova se ekzistojnë disa produkte të ndryshme që i përmbushin të gjitha kërkesat në mënyrë kumulative.

Kjo mangësi është evidentuar edhe në Kërkesën për Rishqyrtim.

Dhe këtu paraqitet një kontradiktë shumë e rëndësishme:

AK pretendon se ka konkurrencë dhe produkte ekuivalente, ndërsa procedura e mëparshme, sipas faktit të paraqitur nga Ankuesi, ka përfunduar me anulim pikërisht sepse asnjë model i ofruar nuk i ka përmbushur specifikimet e njëjta.

Kjo kontradiktë duhet të shqyrtohet nga OSHP.

DËSHMIA E PROCEDURËS SË PARË ËSHTË ELEMENT OBJEKTIV PËR VLERËSIMIN E KONKURRENCËS

OSHP duhet ta marrë në konsideratë jo vetëm formulimin teorik të Dosjes së Tenderit, por edhe **rezultatit real të procedurës së mëparshme.**

Nëse specifikimet:

- kanë qenë të njëjta;
- janë ofruar modele nga operatorë ekonomikë;
- dhe asnjë model nuk ka përmbushur specifikimet;

atëherë ky rezultat është një indikator i fortë se specifikimet mund të jenë **tepër të ngushta, joproporcionale ose të shkëputura nga nevoja reale funksionale.**

Në këtë situatë, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të kufizohet vetëm në përsëritjen e specifikimeve të mëparshme.

Përkundrazi, anulimi i procedurës së parë duhet të shërbejë si **mësim dhe bazë për rishikimin e Dosjes së Tenderit**, në mënyrë që procedura e re të ketë mundësi reale për sukses.

INTERESI I SMART MODEL LLC PËR PJESËMARRJE

SMART MODEL LLC ka interes të drejtpërdrejtë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ankuesi ka kërkuar që specifikimet teknike të ndryshohen jo për t'u favorizuar, por për të krijuar mundësi reale që **edhe modeli/modelët që Ankuesi është në gjendje të ofrojë të mund të konkurrojnë**, nëse përmbushin kërkesat funksionale dhe të performancës së Autoritetit Kontraktues.

Kjo është arsyeja përse, që në fazën paraprake, Ankuesi ka kërkuar:

largimin e parametrave konstruktivë diskriminues dhe riformulimin e tyre mbi bazën e fuqisë, performancës, kapacitetit, standardeve dhe funksionalitetit.

Pra, kërkesa e Ankuesit është e drejtpërdrejtë:

Të na mundësohet pjesëmarrja në tender në kushte të barabarta me operatorët e tjerë, përmes heqjes së kufizimeve konstruktive që nuk janë të domosdoshme për funksionimin e gjeneratorit.

PARIMI I PROPORCIONALITETIT

Kërkesat teknike duhet të jenë:

1. relevante për objektin e kontratës;
2. të nevojshme;
3. proporcionale;
4. të arsyeshme teknikisht;
5. dhe të mos krijojnë pengesa të panevojshme për konkurrencën.

Kërkesa për dimensione të caktuara të motorit, raport të caktuar kompresimi ose konfigurim të caktuar të alternatorit nuk mund të konsiderohet automatikisht funksionale vetëm pse është përfshirë në Aneksin 1.

Ankuesi e ka ngritur këtë çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në Kërkesën për Rishqyrtim.

VAZHDIMI ME TË NJËJTAT SPECIFIKIME RREZIKON NJË TJETËR ANULIM

Duke pasur parasysh rezultatin e procedurës së parë, mbajtja e të njëjtave specifikime krijojnë rrezik serioz që edhe procedura e dytë të përfundojë pa rezultat.

Kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin e prokurimit publik dhe do të krijonte:

- vonesë në realizimin e nevojës së Autoritetit Kontraktues;
- shpenzim të panevojshëm administrativ;
- përsëritje të procedurës;
- mungesë të konkurrencës;
- dhe rrezik të një anulimi të dytë.

Pikërisht për të shmangur një situatë të tillë, Ankuesi ka kërkuar që para vazhdimit të procedurës të korrigjohen specifikimet.

SHKELJET E PRETENDUARA

Në bazë të rrethanave të mësipërme, Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur, ndër të tjera:

1. Nenin 7 të LPP-së

Parimi i barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit, për shkak të kufizimit të konkurrencës.

2. Nenin 28 të LPP-së

Specifikimet teknike, për shkak të vendosjes së kërkesave konstruktive që nuk janë arsyetuar si domosdoshmëri funksionale.

3. Nenin 6 të LPP-së

Ekonomiciteti dhe efikasiteti, në kuptim të nevojës për sigurimin e konkurrencës dhe përdorimin sa më efikas të fondeve publike.

4. Nenin 27 të LPP-së

Në lidhje me kërkesat dhe përgatitjen e specifikimeve të Dosjes së Tenderit.

5. Nenet 108/A dhe 109 të LPP-së

Në lidhje me të drejtën e operatorit ekonomik për mjetet juridike dhe shqyrtimin e pretendimeve të tij.

6. Dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022

Për përgatitjen e Dosjes së Tenderit, specifikimet teknike, rishqyrtimin dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Këto janë edhe dispozitat që Ankuesi ka identifikuar në formularin e Kërkesës për Rishqyrtim.

KËRKESA PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS

Duke pasur parasysh se çështja e ngritur lidhet drejtpërdrejt me **ligjshmërinë e kushteve të pjesëmarrjes dhe specifikimeve teknike**, kërkohet që OSHP të marrë masat e nevojshme për pezullimin e aktivitetit të prokurimit deri në vendosjen përfundimtare.

Vazhdimi i procedurës me specifikimet aktuale mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme, sepse operatorët që nuk mund t'i përmbushin parametrat konstruktivë do të mbeten jashtë procedurës.

Ankuesi ka kërkuar edhe në fazën e rishqyrtimit që aktiviteti të mos vazhdojë mbi bazën e specifikimeve të kontestuar.

KËRKESAT KONKRETE DREJTUAR OSHP-së

Duke u bazuar në të gjitha faktet, argumentet dhe dispozitat e lartcekura, **SMART MODEL LLC i propozon OSHP-së që të nxjerrë:**

V E N D I M

me të cilin:

1. **APROVOHET si e bazuar kjo ankesë e Operatorit Ekonomik SMART MODEL LLC.**
2. **KONSTATOHET** se Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar në mënyrë objektive dhe të verifikueshme domosdoshmërinë e parametrave konstruktivë të përcaktuar në Aneksin 1
3. **KONSTATOHET** se kombinimi i parametrave:
 - 6.49 litra;
 - 6 cilindra;
 - Bore × Stroke 105 × 125 mm;
 - raport kompresimi 16:1;
 - 120 kW Standby / 110 kW Prime;
 - PMG + Dual AVR,

krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës, nëse nuk dëshmohet domosdoshmëria e tyre funksionale.

4. **MERRET PARASYSH si rrethanë relevante fakti se procedura e mëparshme e të njëjtit tender, me specifikime teknike të njëjta, është anuluar pasi asnjë nga modelet e ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë specifikimet e Aneksit 1.**
5. **URDHËROHET Autoriteti Kontraktues që të rishikojë dhe ndryshojë Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit.**

6. **URDHËROHET Autoriteti Kontraktues** që të largojë ose riformulojë parametrat konstruktivë që nuk janë objektivisht të domosdoshëm për përmbushjen e nevojës së kontratës.
7. Specifikimet të riformulohen mbi bazën e:
 - fuqisë;
 - kapacitetit;
 - performancës;
 - funksionalitetit;
 - efikasitetit;
 - standardeve;
 - sigurisë;
 - besueshmërisë;
 - emetimeve;
 - dhe kërkesave të tjera objektive.
8. **URDHËROHET Autoriteti Kontraktues që të mundësojë konkurrimin e produkteve ekuivalente nga prodhues të ndryshëm**, pa kërkuar përputhje identike me konfigurimin konstruktiv të një motori apo modeli të caktuar.
9. Nëse Autoriteti Kontraktues pretendon se parametrat aktualë janë të domosdoshëm, **URDHËROHET që të paraqesë arsyetim teknik të dokumentuar për secilin parametër dhe dëshmi konkrete të ekzistencës së konkurrencës reale.**
10. **URDHËROHET Autoriteti Kontraktues të publikojë amendamentin/korrigjimin e Dosjes së Tenderit në platformën elektronike të prokurimit.**
11. **URDHËROHET zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave**, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë kohë të barabartë dhe të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave pas ndryshimit të specifikimeve.
12. **PEZULLOHET aktiviteti i prokurimit** deri në korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe deri në vendosjen përfundimtare të OSHP-së.
13. Në rast se OSHP vlerëson se shkeljet nuk mund të korrigjohen në mënyrë efektive përmes ndryshimit të specifikimeve, të marrë masat e tjera të parashikuara me LPP.

PËRFUNDIM

SMART MODEL LLC nuk kërkon privilegj, trajtim preferencial apo ndryshim të kërkesave për t'ia përshtatur tenderin një produkti të caktuar.

Kërkesa jonë është që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë **rezultatit teknik që kërkon**, dhe jo të imponojë një konfigurim të veçantë konstruktiv të motorit, për aq sa ky konfigurim nuk është dëshmuar si i domosdoshëm për përmbushjen e nevojës.

Në këtë rast ekziston një rrethanë objektive që e bën pretendimin e Ankuesit veçanërisht të rëndësishëm:

I njëjti tender, me të njëjtat specifikime teknike, është zhvilluar më parë dhe është anuluar pasi asnjë operator ekonomik me modelet e ofruara nuk ka arritur t'i përmbushë specifikimet teknike të Aneksit 1.

Përkundër këtij rezultati, Autoriteti Kontraktues ka vendosur që në procedurën e re të vazhdojë me të njëjtat specifikime, pa i korrigjuar parametrat që kanë krijuar pengesë reale në procedurën e parë.

Kjo e bën të arsyeshme dhe të domosdoshme ndërhyrjen e OSHP-së.

Ankuesi ka kërkuar që këtë herë, përmes largimit të parametrave konstruktivë diskriminues, **t'i mundësohet pjesëmarrja në tender**, së bashku me operatorët e tjerë që ofrojnë produkte me performancë dhe cilësi ekuivalente.

Nëse Autoriteti Kontraktues realisht synon të sigurojë një gjenerator me kapacitetin, fuqinë, performancën dhe cilësinë e kërkuar, atëherë nuk ekziston arsye që operatorët ekonomikë të detyrohen të ofrojnë një konfigurim të caktuar të motorit, përderisa produktet e tyre përmbushin **kërkesat funksionale dhe të performancës**.

Prandaj, mbajtja e të njëjtave specifikime pas anulimit të procedurës së parë krijon rrezik serioz të përsëritjes së të njëjtit rezultat dhe bie ndesh me qëllimin e një procedure të hapur dhe konkurruese.

Për këto arsye, kërkojmë nga **OSHP** që ta aprovojë këtë ankesë, të konstatojë shkeljet e pretenduara dhe të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të **largojë/riformulojë specifikimet teknike diskriminuese dhe të mundësojë pjesëmarrjen reale të operatorëve ekonomikë dhe produkteve ekuivalente**.

DOKUMENTET QË PROPOZOHEN TË BASHKËNGJITEN

1. **Kërkesa për Rishqyrtim e SMART MODEL LLC, datë 13.08.2026;**
2. **Përgjigjja/Vendimi i Autoritetit Kontraktues ndaj Kërkesës për Rishqyrtim;**
3. **Dosja e Tenderit – Aneksi 1, Specifikimet Teknike;**
4. **Njoftimi i aktivitetit aktual të prokurimit;**
5. **Dokumenti/Njoftimi për anulimin e procedurës së parë;**
6. **Vendimi për anulimin e tenderit të parë, ku evidentohet arsyeja e anulimit;**
7. Dokumentet e procedurës së parë që dëshmojnë modelet e ofruara dhe mospërmbushjen e specifikimeve;
8. Çdo përgjigje/sqarim i Autoritetit Kontraktues;
9. Dokumentacioni teknik i produkteve që SMART MODEL LLC synon të ofrojë;
10. Çdo dëshmi tjetër që provon se produkti i Ankuesit përmbush kërkesat funksionale dhe të performancës së gjeneratorit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Mosrespektimi i dispozitave të LPP-së i shkakton operatorit ekonomik:

- pamundësi reale për pjesëmarrje në procedurë;
- humbje të mundësisë për konkurrim të barabartë;
- dëmtim ekonomik dhe reputacional;
- cenim të besimit të operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit publik.

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim ashtu edhe për përgatitjen e ankesës.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- I....T&C...@E.....C

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.